



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVA

C-III.-19-0079

Paditësi:

K.T., Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati

Kundër:

E paditura:

KBI, Prizren, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kolegji i përbërë nga Teuta Ibrahim, gjyqtare kryesuese, Diellza Hoxha dhe Gazmend Sylaj, gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 9 shtator 2019, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. **Kërkesa për masë të sigurimit, refuzohet si e pabazuar.**
2. **Nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Më 9 prill 1996, Gjykata Komunale në Prizren ka nxjerrë aktgjykimin me nr. P.br.593/94, përmes së cilit ka anuluar kontratën Leg. Nr. 1511/63 të datës 27 shtator 1963, e lidhur ndërmjet babait të paditësit A.T.dhe KBI .

E paditura sipas kontratës së anuluar me aktgjykim të plotfuqishëm ka qenë e obliguar që paditësit t’ia kthejë ngastrat kadastrale nr. 733 dhe 737 në ZK L, si dhe ngastrën kadastrale nr. 296 në ZK P dhe ngastrën kadastrale nr. 288 në ZK P.

Më 22 tetor 2001, Gjykata Komunale në Prizren nxjerr aktgjykimin C.nr. 782/96 sipas të cilit e paditura urdhërohet për t'ia kthyer paditësit ngastrat kadastrale nr. 733 dhe 737 në ZK L si dhe ngastrën kadastrale nr. 296 në ZK P , mirëpo për ngastrën kadastrale nr. 288 në ZK P paditësi e ka tërhequr padinë e tij.

Prandaj përmes këtij aktgjykimi kërkesa është konsideruar e tërhequr lidhur me kthimin e ngastrës kadastrale nr. 288 në ZK P

Sipas dokumentacionit të bashkëngjitur kadastral tani janë bërë disa ndryshime kadastrale dhe ngastra kadastrale nr. 288 në ZK P është ndarë në dy pjesë, respektivisht në ngastrën kadastrale nr. 288-1 dhe 288-2.

E paditura gjithashtu ka tjetërsuar pjesën ideale prej 1/3 te personat e tretë, përkatësisht tani si pronarë evidentohet e paditura me 2/3 e pjesës ideale dhe personat e tretë me 1/3.

Më 7 gusht 2019, paditësi K.T. përmes avokatit të tij përfaqësues ka parashtruar padi për kthimin e pronave.

Në mbështetje të pretendimeve të tyre si provë kanë dorëzuar:

- Aktgjykimin e plotfuqishëm P.br. 593/94
- Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C. Nr. 782/96
- Historiatin e ngastrës kadastrale nr. 288 në ZK P
- Certifikatën e pronësisë për ngastrat 288-1 dhe 288-2.

Përmes kësaj padie paditësi gjithashtu kërkon nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme nxjerrjen e një aktgjykimi për të aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e tij, të obligojë të paditurën që t'ia kthejë pronën paditësit pjesët për 2/3 të ngastrave kadastrale nr. 288-1 dhe 288-2 në ZK P dhe po ashtu obligohet që t'ia kompensoj paditësit pjesët ideale prej 1/3 të cilat i ka tjetërsuar me një ngastër kadastrale tjetër me vlerë të njëjtë; të obligojë shërbimin kadastral në Prizren që këtë vendim ta pranoj si titull juridik dhe të regjistroj ngastrat e lartcekura në emër të paditësit brenda 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi dhe që shpenzimet t'i paguajë e paditura deri në fund të procedurës.

Avokati përfaqësues gjithashtu përmes kësaj padie ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme që të caktojë masë të sigurisë dhe t'i ndalohej të paditurës tjetërsimi, shitja apo formë tjetër e ndryshimit të gjendjes ekzistuese të ngastrave kadastrale të lartpërmendura, dhe të obligojë Zyrën Kadastrale Komunale në Komunën e Prizrenit dhe Noterëve në këtë region që masën e kërkuar të sigurisë ta evidentojnë në regjistrat përkatës të tyre.

Më 23 gusht 2019, gjyqtarja e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme ka lëshuar një urdhër për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes së cilit ka kërkuar që në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, të dërgojnë një përgjigje brenda shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të urdhrit.

Më 29 gusht 2019, Agjencia Kosovare e Privatizimit dorëzon në Dhomë të Posaçme përgjigjen e saj në kërkesën e paditësit për masën e sigurimit.

Përmes përgjigjes së saj AKP-ja në tërësi kundërshton pretendimin e paditësit si të pabazuar në ligj dhe kërkon nga Dhoma e Posaçme që të hedhë poshtë kërkesën e paditësit për masë të sigurimit apo ta refuzojë atë si të pabazuar në ligj.

AKP-ja konsideron se, paditësi nuk ka argumentuar me prova të besueshme materiale për ta bërë të besueshme kërkesën dhe mbi këtë bazë DHPGJSK do të pranonte meritat e padisë.

AKP-ja tutje thekson se nuk është plotësuar kushti *periculum in mora* (rreziku i drejtpërdrejtë i shkakimit të dëmit dhe se paditësi ka dështuar ta bindë gjykatës se lëshimi i masës së sigurimit është i domosdoshëm, i drejtë dhe i arsyeshëm.

Sipas AKP-së nuk është plotësuar kushti ligjor për lëshimin e masës së sigurimit *focus boni turis* (mundësia se e drejta ekziston) dhe nga kjo arsye edhe kërkesa duhet refuzuar si e pabazuar.

Arsyetimi Ligjor:

Kërkesa për masë të sigurimit është e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Sipas Nenit 61 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji për Dhomën e Posaçme), Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Sipas formulimit të mësipërm Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme, ndërsa në rastin konkret nuk është paraqitur ndonjë rrethane nga ana e paditësve, me anë të së cilës do të bëhej i besueshëm fakti se dëmi është i menjëhershëm dhe i pa riparueshëm.

Paditësi i cili kërkon masën e sigurimit duhet të dorëzoj dëshmi të besueshme se:

1. ekziston e drejta, dhe
2. kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të riparueshme nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Barra e provës është tek paditësit, kështu që paditësit përveç që duhet të ofrojnë dëshmi të besueshme se e drejta e rrezikuar ekziston, duhet të ofrojë dëshmi dhe ta bëjë të besueshme faktin se do të shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i riparueshëm, nëse nuk aprovohet kërkesa për masë të sigurimit.

Në këtë aspekt gjykata konstaton se nuk janë plotësuar kushtet e dispozitës së nenit 61 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për caktimin e Masës së sigurimit,

pasi që paditësit nuk pritet të pësojë ndonjë dëmi të menjëhershëm dhe të pariparueshëm, meqë sipas kërkesave ligjore përveç që duhet të bëhet e besueshme e drejta e pretenduar, duhet që paditësit të dorëzojnë dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të pariparueshme nëse nuk miratohet kërkesa. Në rastin konkret paditësi nuk ka ofruar prova të besueshme materiale se këto parcela janë nxjerr në shitje pa paragjykuar rrezikun në të ardhmen dhe themelësinë e kërkesës kryesore, një rrezik i tillë për momentin paditësi nuk ka ofruar prova se ekziston.

Pra nisur nga fakti se propozimi për caktimin e masës e sigurisë është parashtruar nga paditësit në atë drejtim që parcelat që janë objekt kontesti, të mos mund të tjetërsohen/ ngarkohen dhe duke marr parasysh argumentet e lartcekura se një rrezik i tillë i pretenduar nuk ekziston, gjykata vlerëson se kërkesa për masë të sigurimit është e pa bazuar.

Paditësit, në të ardhmen mund të paraqesin një kërkesë të re për lëshimin e masës së sigurimit, nëse e paditura me veprime konkrete tenton ta tjetërsoj apo ngarkoj objektin e kontestit, por tani për tani një rrezik i tillë nuk ekziston.

Nga arsyet e theksuara Gjykata konstaton se propozimi i paditësit për caktimin e masës së sigurimit nuk ka mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, prandaj kërkesa si e tillë u refuzua.

Shpenzimet Gjyqësore

Paditësi tanimë e ka paguar taksën gjyqësore lidhur me kërkesën për masë të sigurimit në shumë prej 100.00 €, sipas urdhërpagesës së datës 8 gusht 2019 dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Këshillë Juridike

Kundër këtij Aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Teuta Ibrahim, Gjyqtare Kryesuese _____

Diellza Hoxha, Gjyqtare _____

Gazmend Sylaj, Gjyqtar _____